



Ministry of Foreign Affairs of the
Netherlands

**DEFENCE for
CHILDREN** 



Terre des hommes

Ndihmë për fëmijët.

Protokoll i Punës për Menaxhimin e Rastit të një Fëmije në Konflikt me Ligjin (i përshtatur për fëmijë)



Fjalori:

Tani do të futeni pak në botën e të rriturve duke mësuar fjalorin e tyre të ndërlikuar por në një gjuhë miqësore dhe të përshtatur për ju.

Protokoll Fletore me këshilla ose fletore pune e Ligjit me qëllim që të gjithë të rritur dhe fëmijë ta kuptojnë si duhet ligjin dhe të veprojnë njësoj në interesin më të mirë për fëmijën.

Ligji Libri kryesor me tërësinë e rregullave.

I mitur Fëmijë nga 0-18 vjeç.

Fëmijë në konflikt me ligjin Është një fëmijë i përfshirë në vepra të ndryshme penale të parashikuara nga ligji. Një fëmijë në kontakt me ligjin mund të jetë viktimë ose dëshmitar.

I pandehur Një i rritur ose fëmijë i dyshuar që mund të ketë shkelur ligjin. Ai/ajo që mund ose jo të ketë kryer një veprim që bie në kundërshtim me çfarë ligji pret të sillemi dhe akuzohet.

Procedim Penal Një akuzë/ankesë e ngritur ligjërisht për një fëmijë 14-18 vjeç.

Veprë Penale Shkelje e ligjit kur fëmija është mbi 14 vjeç.

Kundravajtje Penale Shkelje e lehtë e ligjit kur fëmija është mbi 16 vjeç.

Menaxhim rast Bashkësi veprimesh që si një gjetje thesari e çojnë fëmijën tek thesari kryesor i cili është mirëqënia e tij, vendi ku janë të plotësuara nevojat dhe të drejtat tuaja. Këto veprime i kryejnë të rriturit (profesionistët) për të bërë më të mirën për ju.

PIM Plani Individual i Mbrojtjes është një plan i cili ju tregon rrugën me hapa drejt mirëqënies tuaj dhe vendit ku nuk do jeni më në konflikt me ligjin por në harmoni me të dhe as të cënuar nga një situatë apo njerëz të tjerë.

PMF Punonjësi/ja e Mbrojtjes së Fëmijëve është profesionisti që ju ndihmon ju që të respektohen të drejtat tuaja dhe të bëhet më e mira për ju. Ai/Ajo drejton GTN-në (një grup të rriturish profesionistë) dhe sigurohet që të gjithë të ndjekin rrugën dhe veprimet e duhura që të drejtat tuaja të respektohen dhe ju të jeni të mbrojtur. Ai/Ajo kujdeset që PIMI të ndjekë rrugën e duhur.

Hartuesit e politikave Kush shkruan politika në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve.

Rehabilitim Fitoj të drejtat ose gjendjen që kisha humbur.

IEVP (Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale) Institucioni ku zbatohet vendimi që është marrë për fëmijën në rast se është vendosur masa e burgimit ose masë arresti.

Sistemi i mbrojtjes së fëmijëve në konflikt me ligjin janë disa shërbime në shumë fusha të ndryshme.

Alternativë e dënimit me burgim është një masë që vendoset ndaj autorit të veprës penale, atij që ka shkelur ligjin nga prokurori ose gjykata. Kjo masë nuk lejon që fëmija të dënohet me heqjen e lirisë me paraburgim ose me burgim.

Drejtësia penale për të mitur Procedura që lidhen me veprat penale, duke përfshirë: hetimin, ndjekjen penale, procesin gjyqësor, ekzekutimin e dënimit dhe çdo masë tjetër që përfshin një të mitur në konflikt me ligjin, viktimë ose dëshmitar të një vepre penale.

Faktorët mbrojtës rrethana që kanë efekte pozitive dhe ulin mundësinë e pasojave të rrezikshme.

Faktorët e rrezikshmërisë janë rrethana të cilat rrisin mundësinë që individi të përjetojë rezultate negative.

Fëmijë është çdo person nën moshën 18 vjeç. Termi “i mitur” ka të bëjë me fëmijën që ka mbushur moshën e përgjegjësisë penale (14 vjeç për krime dhe 16 vjeç për kundërvajtje penale).

Fëmijë në nevojë për mbrojtje është personi nën moshën 18 vjeç, i cili mund të jetë viktimë e abuzimit, lënies pas dore, shfrytëzimit, diskriminimit, dhunës apo i një veprimtarie kriminale.

Zotësia për të vepruar zotësi që fitohet pjesërisht në moshën 14 vjeç, ndërsa plotësisht në moshën 18 vjeç.

Mbrojtje e fëmijës quhet parandalimi dhe përgjigjja ndaj fenomeneve të dhunës, keqtrajtimit, shfrytëzimit dhe nënveftësimit që i bëhet fëmijës duke përfshirë: rrëmbimin, shfrytëzimin seksual, trafikimin dhe punën e fëmijës.

Mosha e përgjegjësisë penale është kusht për përgjegjësinë penale dhe dënimin penal të individit. Individit që nuk e ka mbushur moshën, nuk i nënshtrohet procedimit penal dhe nuk dënohet. Kodi Penal ka caktuar moshën më të ulët të fëmijës që nuk shkon në procedim penal. Kështu kjo moshë, për krimet është 14 vjeç, ndërsa për kundërvajtjet 16 vjeç.

Ndërmjetësim është procesi i zgjidhjes së një mosmarrëveshjeje jashtë gjykatave përmes dialogut i cili zhvillohet nga një ndërmjetës i licencuar sipas ligjit. Në rastin e të miturit në konflikt me ligjin, ndërmjetësimi kryhet mes të miturit që ka kryer veprën penale dhe viktimës.

Ndihma juridike falas është një shërbim i specializuar ligjor i cili garantohet falas për fëmijën duke u financuar nga shteti.

Përfaqësuesi ligjor është prindi, i afërmi ose kujdestari ligjor që merr pjesë në procedurë për të mbrojtur interesat e fëmijës. Vetëm kur mungon përfaqësuesi ligjor ose nuk ka mundësi të paraqitet, vendin e tij e zë përfaqësuesi procedural.

Përfaqësuesi procedural është personi që dërgon njësia për mbrojtjen e fëmijës. Duhet ditur se përfaqësuesi procedural është një figurë që zëvendëson përfaqësuesin ligjor të fëmijës, pra, është një figurë tjetër dhe e ndryshme prej tij.

Mbrojtësi është avokat që merr pjesë në procedurat që zhvillohen me të miturin për të garantuar mbrojtjen sa më të mirë dhe profesionale të të miturit. Një fëmijë në konflikt me ligjin mund të ketë njëkohësisht edhe mbrojtës, edhe përfaqësues procedural.

Person i besuar është ai person madhor (mbi 18 vjeç) i cili e shoqëron të miturin në fazat e procedimit penal. Ai/ajo është kërkuar nga i mituri dhe i pranuar nga organet kompetente.

Përvojat negative të fëmijërisë është një term që përdoret për të përshkruar të gjitha llojet e abuzimeve, të lënies pas dore dhe përvojave të tjera traumatike në fëmijëri.

Pjesëmarrje e fëmijës është një proces i vazhdueshëm i përfshirjes së tij aktive, si dhe i respektimit të së drejtës që ka ai për t'u shprehur dhe për t'u dëgjuar në të gjitha nivelet e vendimmarrjes për çështje të lidhura me të.

Procedurë civile janë hapat që ndiqen për zgjidhjen e një çështjeje sipas normave dhe rregullon marrëdhënien midis personave.

Psikologu mbështetës është profesionist i domosdoshëm që mbështetut emocionalisht të miturin në konflikt me ligjin dhe lehtëson komunikimin me të përgjatë procedimit penal.

Sistemi i integruar i mbrojtjes së fëmijëve është tërësia e ligjeve, politikave dhe shërbimeve që ndihmojnë mirëqenien sociale, edukimin, shëndetin dhe sigurinë, me qëllim parandalimin dhe përgjigjen ndaj rreziqeve ndaj fëmijëve, që shfaqen gjatë zbatimit të tyre.

Shërbimi shumëdisiplinor është tërësia e shërbimeve për të mbështetur fëmijën/ të miturin në gjetjen e zgjidhjes më të përshtatshme për riintegrimin e tij/ saj.

Vepër penale është shkelje e ligjit, e kryer me veprim ose mosveprim, me vullnet apo pa vullnet nga individi, shkelje për të cilën ligji përcakton dënim penal.

Veprimi procedural është çdo hap i parashikuar nga ligji dhe i dokumentuar, i cili kryhet nga organi i ngarkuar prej ligjit për të zgjidhur çështjen. P.sh një veprim procedural është caktimi i mbrojtësit për fëmijën.



Hyrje

Ndoshta keni dëgjuar fëmijë, por një prej problemeve me të cilin përballen fëmijët sot është të qenurit në kontakt dhe konflikt me ligjin.

Një kuriozitet për ju, nëse ende nuk e dini!!!

Janë miratuar disa ligje që kanë fëmijët në qendër të tyre (Ligji për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur dhe aktet nënligjore). Gjithashtu janë ngritur disa struktura të përkushtuara shtetwrore. Studimet na thonë se të gjitha ligjet për fëmijët që kanë nevojë për mbrojtje në Shqipëri janë po aq të mira sa ato të shteteve të tjera.

POR KUJDES FEMIJË!!!

Sjellja dhe bashkëpunimi i të rriturve profesionistë për më të mirën tuaj duhet të përmirësohet. Rruga e ndjekur duhet të jetë më e shpejtë dhe me sa më pak dëme për ju.

Çfarë është një protokoll? Lexo më poshtë:

Një kuriozitet për ju fëmijë: “Emri protokoll rrjedh nga një fjalë e lashtë greke (protokollen: proto që do të thotë i pari dhe kollo që do të thotë ngjites).”

Si dhe në sa pjesë ndahet Protokollin?

Protokollin ndahet në 4 pjesë si më poshtë:

Përse na duhet kjo fletore me këshilla?

Ky protokoll krijon mundësinë që ligji i shkruar të kuptohet njësoj nga ne të gjithë, të rritur dhe fëmijë, dhe të mund të zbatohet në njëjtat rregulla për mbrojtjen tuaj. Protokollin është si një **fletore pune** e mbushur me këshilla praktike dhe rregulla.

Protokollin i punës është një mjet informues për profesionistët e mbrojtjes së fëmijës, por edhe për vetë fëmijën në kontakt dhe konflikt me ligjin dhe për familjen e tij. Në këtë mënyrë fëmija dhe familja e tij janë në gjendje të identifikojnë të drejtat dhe shërbime që duhet të kërkojnë lidhur me mbrojtjen e integruar, të ofruar nga ligji në fuqi.

Kush e përdor këtë fletore me këshilla? (ose Fletoren me këshilla siç vendosëm ta quajmë ne)

Të gjithë profesionistët që ndihmojnë fëmijët të cilët bien në kontakt ose konflikt me ligjin.

Cilat janë Strukturat e Sistemit të Mbrojtjes së Fëmijëve?


Sistemi i mbrojtjes së fëmijës në kontakt dhe konflikt me ligjin është i përbërë nga një numër institucionesh dhe organizatash që punojnë së bashku për të njëjtin qëllim që është mbrojtja e fëmijëve, garantimi i mirëqenies dhe përmirësimi i cilësisë së jetës së fëmijës.

Ashtu si ligji na thotë fëmijë, strukturat që veprojnë për mbrojtjen e fëmijës mund të ndahen në dy nivele: qendror dhe vendor.

Në nivel qendror bëjnë pjesë Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, Ministri i Shëndetësisë dhe i Mbrojtjes Sociale, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, gjykata, prokuroria, policia e shtetit dhe shërbimi i provës, që sigurojnë lidhjen ndërmjet drejtësisë dhe Sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijëve.

Në nivel vendor veprojnë bashkitë, struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore, Njësia e mbrojtjes së fëmijës, grupe profesionistësh etj.

PMF Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijëve është i rrituri profesionist që ju shoqëron gjatë gjithë kohës në rrugën e menaxhimit të rastit. PMF është profesionisti që ju ndihmon të respektohen të drejtat dhe të bëhet më e mira për ju. Ai/Ajo drejton Grupin Teknik Ndërsektorial dhe sigurohet që të gjithë të ndjekin rrugën dhe veprimet e duhura. PMF kujdeset që Plani individual i mbrojtjes për fëmijët të zbatohet për interesin më të mirë të fëmijës.



Menaxhimi i Rastit

Çfarë është menaxhimi i rastit? Menaxhimi i rastit nuk është gjë tjetër veçse një bashkësi me hapa dhe njerëz. Këto hapa të çojnë tek një **THESAR**. Thesari jeni ju fëmijë me të drejtat dhe mirëqënie tuaj. Menaxhimi i rastit është si zgjidhje e një QUIZI. Nëse ju keni shkelur ligjin, atëherë diçka nuk ka shkuar siç duhet, ndaj situata duhet menaxhuar. Në të njëjtën mënyrë edhe kur ju janë shkelur të drejtat.


Menaxhimi i rastit është bashkësia e të gjitha veprimeve që kryejnë të rriturit që punojnë në institucionet që mbrojnë fëmijët. Këto hapa bëhen me qëllim që të drejtat e fëmijëve që janë shkelur të mund të plotësohen. Kur vetë fëmijët bien në konflikt me ligjin, menaxhimi i rastit ndihmon që sjellja e fëmijës të përmirësohet dhe ai të rikthehet në mjedisin e tij duke u rritur i shëndetshëm.

Hapat e menaxhimit të rastit të fëmijës në kontakt dhe konflikt me ligjin

- Regjistrimi i rastit – Vënia në dijeni me incidentin
- Vlerësimi fillestar – Takojmë fëmijën
- Vlerësimi i plotë – Kuptojmë çfarë ka nevojë fëmija, mendimet dhe dëshirat e tij/saj
- Hartimi i Planit Individual të Mbrojtjes (PIM) – Harta e Thesarit
- Zbatimi i Planit individual të mbrojtjes – Ndjekim dhe zbatojmë veprimet
- Mbyllja e rastit – Të gjithë gjejnë thesarin dhe vendin ku fëmija është në mirëqënie dhe i mbrojtur

Pasi PMF-ja ka marrë dijenipër rastin dhe ka informacionin e duhur ajo mbledh GTN-në një grup të rriturish profesionistë që takohen sa herë një fëmijë ka nevojë për mbrojtje.

Mos e harroni!!! Çdo fëmijë është i veçantë, ndaj për të bërë më të mirën për të, formohet **GTN-ja** veçanërisht për të mbrojtur fëmijën.



Në GTN marrin pjesë një grup profesionistësh si mësues, psikologë, punonjës policie, mjekë dhe punonjësi/ja e mbrojtjes së fëmijës. Ky grup së bashku me prindërit ose kush kujdeset për fëmijën diskutojnë për më të mirën e fëmijës dhe ndërtojnë PIM-in.

PIM është plani individual i mbrojtjes për fëmijët në kontakt me ligjin. PIM-i është si harta e një thesari që formon GTN-ja. PIM-i ju tregon rrugën me hapa dhe kohë të përcaktuar drejt mirëqënies tuaj dhe vendit ku ndjeheni të mbrojtur, të sigurt dhe mirë.

Por kujdes fëmijë! Që të funksionojë ky plan **GTN-ja duhet të ketë kujdes se mund t'i kalojë afati i veprimeve dhe GAME OVER (loja mbaron)**. Dhe mbi të gjitha duhet patjetër ndihma, dëshira dhe vullneti juaj. Ndaj nëse e gjeni ndonjëherë veten në këtë situatë, kërkoni të merrni pjesë në vendimet që merren për ju!

Mos dyshoni fare! Ju jeni kryesorët në këtë plan. Ndaj mendimet tuaja janë shumë të rëndësishme dhe nëse nuk jeni dakord me diçka që grupi ka vendosur në plan ju mund ta përmirësoni atë.

Qëllimi kryesor i menaxhimit të rasteve për mbrojtjen e fëmijëve është parandalimi dhe përgjigjja ndaj nevojave të fëmijëve të cilët përjetojnë ose rrezikojnë abuzim, nënvleftësim, dhunë dhe shfrytëzim, mos realizim të të drejtave të tyre përmes shërbimeve sociale që garantojnë të drejtat dhe mirëqënien e fëmijës.

Veprimet paraprake

Një kuriozitet për ju fëmijë!

A e dini se që çdo gjë të sigurohet të ndodhë sipas ligjit, duhet që të kryhen disa veprime më parë se të kalohet në menaxhim rasti. Këto veprime janë si më poshtë:

Ligji garanton një të rritur që ju përfaqëson dhe siguron që veprimet që merren janë në të mirën tuaj. Këta të rritur janë pjesë e një liste që përzgjidhet me kujdes të veçantë dhe quhen përfaqësuesit proceduralë për fëmijët në kontakt dhe konflikt me ligjin.

Po kush janë përfaqësuesit procedural për ju fëmijë?

Përfaqësuesi procedural është personi që dërgon njësi për mbrojtjen e fëmijës. Duhet ditur se përfaqësuesi procedural është një figurë që zëvendëson përfaqësuesin ligjor të fëmijës, pra, është një figurë tjetër dhe e ndryshme prej tij.

Për sa kohë ju jeni nën 18-vjeç, ju keni nevojë që dikush t'ju përfaqësojë, të flasë në emrin tuaj dhe të sigurohet që të drejtat tuaja janë të mbrojtura, kjo duhet të gjendet në çdo bashki. **Të përgatiten informacione të përkushtuara**, duke vendosur njoftime ku janë kontaktet e të gjitha institucioneve dhe organizatave që mund t'ju ndihmojnë. Një shërbim për të gjithë fëmijët në nevojë për mbrojtje, është edhe Linja telefonike **Alo 116 111**.

Të parandalohet! Parandalimi është ndërhyrja kur fëmijët janë ende të vegjël dhe ka për qëllim që fëmijët të kenë informacion nëse kryejnë veprime që shkelin ligjin, siç janë veprat penale, ende pa rënë në kontakt ose konflikt me ligjin.

Identifikimi i rastit

Kur hyni në konflikt me ligjin? Fëmija hyn në konflikt me ligjin atëherë **kur vërtetohet** se e ka kryer një vepër penale për të cilën ai dyshohet se është autor. Identifikimi i rastit bëhet nga njësia e mbrojtjes së fëmijëve ose nga të tretët, që e referojnë rastin tek ajo (NjMF-ja). Këto mund të jenë edhe ju.

Raportimi ose referimi i rasteve ka rëndësi thelbësore sepse është e vetmja mënyrë që të merret vesh ligjërisht situata e fëmijës në konflikt me ligjin ose në nevojë për mbrojtje.

Informacion: Ku ndryshon rruga penale nga rruga civile?

Qëllimi i rrugës penale ndryshon nga qëllimi i rrugës civile. Rruga penale për të rriturit vë para përgjegjësisë penale autorin që ka shkelur ligjin. **Por**, për fëmijën kjo rrugë merr parasysh nevojat e tij duke e integruar në mënyrë të suksesshme në shoqëri. Fëmija gëzon të drejtat për t'u marrë në mbrojtje të veçantë.

Hapat e rrugës penale? Rendisni hapat duke vendosur numrin:

- 1- gjejmë nivelin që një fëmijë mban përgjegjësi
- 2- gjejmë masën e përshtatshme duke bërë vlerësime individuale të fëmijës
- 3- mbështesim hapin e rehabilitimit, rikthimin në gjendjen e mëparshme
- 4- zbatimin me sukses të hapave më lart përshirë PIM-i.
- 5- ri-integrimi i plotë i fëmijës.

Gjetja e thesarit dhe rruga drejt mirëqënies së tij

Rruga penale ndahet në tri hapa, që janë:

1- PARANDALIM 2- MARRJA E MASAVE 3- RI-INTEGRIM

Profesionistët që ndihmojnë fëmijët në sistemin e drejtësisë dhe sistemin e mbrojtjes së fëmijës janë:

Gjyqtari; Prokurori; Punonjësi i policisë së shtetit; Punonjësi i policisë gjyqësore; Psikologu; Ndërmjetësi; Punonjësi social; Punonjësi i Njësive për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës; Punonjësi i shërbimit të provës; Punonjësi i institucionit të rehabilitimit të të miturve; Punonjësi i paraburgimit dhe i burgjeve; Punonjësi i Qendrës për Parandalimin e Krimit tek të Miturit dhe të Rinjtë (QPKMR); si dhe çdo strukturë/zyrtar tjetër që përfshihet në këtë proces (psh. përkthyesi, përfaqësuesi procedural etj).

Mos harroni fëmijë! PMF-ja ju shoqëron në çdo hap në rrugën tuaj drejt ri-integrimit dhe parandalimit që ngjarja të mos ndodhë përsëri.

Vini re fëmijë!!! Identifikimi i një fëmije të përfshirë në sistemin e drejtësisë mund të bëhet në çdo hallkë të procesit dhe nga çdo institucion ose jo. Në të dyja këto faza të procedimit penal PMF-ja kontribuon në veprimet të mëposhtme procedurale:

- **Vlerësimi individual i të miturit nga eksperti ose Shërbimi i provës**

Vlerësimi individual i fëmijës në konflikt me ligjin kryet edhe nga profesionistë tek insitucioni i Shërbimit të Provës (shërbim që monitoron dhe ndjek masat e dhëna nga gjykata jashtë intitucioneve të mbyllura). PMF-ja jep informacion nga vlerësimi që ka kryer te profesionistët ose insitucioni i Shërbimit të Provës që ndihmojnë fëmijën.

- **Shmangia dhe ndërmjetësimi**

Shmangia kërkon për ju fëmijë që të mos ecni në rrugën e drejtësisë penale, të mos mësoni duke u ndëshkuar, por nëpërmjet rehabilitimit dhe parandalimit që kjo situatë të mos përsëritet.

PMF-ja mund ta ndihmojë procesin duke i ofruar prokurorit/ gjyqtarit/ ndërmjetësit/ prindit/ të miturit mendimin e saj në këtë proces. Ndaj duhen kuptuar arsyet se përse fëmija e ka kryer një veprim dhe të mundësohet edhe pajtimi mes të lënduarit dhe autorit, në këtë rast fëmijës.

- **Ndërmjetësimi**

si masë shmangieje, mund të propozohet nga prokurori gjatë hetimit dhe gjyqtari gjatë gjykimit, nëse vlerësojnë se kjo alternativë është më e përshtatshme.

- **Këshillimi për të miturin dhe familjen**

ka të bëjë me informimin e të miturit dhe/ose familjes së tij, se ai ka kryer një veper të dëmshme, të rrezikshme, e cila përbën veper në shkelje të ligjit dhe me pasoja negative për viktimën dhe komunitetin.

Njoftimi për masën detyruese, veç të miturit dhe përfaqësuesit të tij ligjor dhe/ose procedural, i përcillet edhe autoritetit përgjegjës në fushën e arsimit dhe/ose të formimit profesional, të punësimit, shëndetësisë, Shërbimit të Provës dhe PMF-së. Është gjykata/prokuroria, që sipas rastit, do të caktojë ose Shërbimin e Provës ose NJMF që të mbikëqyrë realizimin e këtyre masave.

Ekzekutimi i dënimit/masës penale, kur merret vendimi nga gjykata dhe prokuroria se cila masë do të zbatohet për fëmijën/të miturin pas vlerësimeve të para, hapi tjetër është plani se si ky vendim do duket në jetën e fëmijës. IEVP- (Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale) Institucioni ku zbatohet vendimi që është marrë për fëmijën në rast se është vendosur masa e burgimit ose masë arresti.

Në disa raste fëmijë, mundet që të hiqet liria për shkak burgimi ose paraburgimi. Në këtë rast PMF-ja informohet për datën e mbarimit të dënimit nga ana e IEVP-së pasi merr pjesë në hartimin e planit të rishoqëzimit dhe rehabilitimit. Ajo e miraton dhe siguron përmbushjen e tij. Çdo ndihmë duhet të ofrohet për të paranduar që fëmija/i mituri të rikthehet në mjedisin e parë dhe rrethanat që shkaktuan që ai të shkelte ligjin.

KURIOZITET!!! Sot, në sistemin e burgjeve në Shqipëri ka vetëm një Institucion të Ekzekutimit të Vendimeve Penale për të miturit – IEVP-ja në Kavajë, pra vetëm një institucion i përshtatur për fëmijë/të mitur.

KUJDES!!! Një vëmendje e veçantë i kushtohet trajtimit të familjes, si në rastin kur fëmija ka marrë dënim alternativ, ashtu edhe kur ai ka marrë dënim me burg. Për këtë PMF-ja komunikon me Njësinë e Vlerësimit e Referimit të Rasteve.

VINI RE!!! Në përfundim të dënimit apo në rast lirimi me kusht të fëmijës/të miturit duhet të mbahet parasysh, që ai ta kuptojë se çfarë ndikimi negativ mund të kish pasur sjellja e tij, si dhe të kuptojë gjithashtu shkaqet që e çuan në kryerjen e asaj vepre.

MOS HARRONI se në planin e shoqëzimit dhe rehabilitimit, Punonjësi i mbrojtjes së fëmijëve duhet t'i nxisë e t'i ndihmojë të miturit dhe familjet e tyre për t'i njohur e pranuar përgjegjësitë e tyre. I mituri dhe familja duhet të vihen në dijeni të këtij plani deri në 24 orë pasi ky plan është miratuar.

VINI RE!!! Kur fëmija është nën moshën e përgjegjesisë penale rasti i tij menaxhohet në rrugë më të lehta sesa dënimi.

Në çdo rast Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës pranë Bashkisë ose Njësisë administrative kujdeset për rastin e fëmijës që nga identifikimi deri në mbylljen e rastit.

Të gjithë të rriturit dhe organizatat që punojnë me/për fëmijët, duhet të bëjnë ç'është më e mira për çdo fëmijë. Për mbrojtjen e të miturit duhet të kujdesen të gjithë.

- Prindi ose kujdestari i fëmijës
- Bashkëmoshatarët
- Njerëzit që jetojnë pranë fëmijës dhe familjes së tij duke i ofruar ndihmën e nevojshme për të ndihmuar prindërit për të krijuar një mjedis të përshtatshëm, ku i mituri mund të rritet dhe të zhvillohet në mënyrën më të mirë të mundshme
- Shtetin i cili ofron shërbimet e nevojshme për të gjitha familjet/kujdestarët për të mbrojtur të drejtat e fëmijëve dhe plotësuar çdo nevojë dhe për të garantuar sigurinë dhe zhvillimin e tij e të miturit

Nëse një fëmijë nën 14 vjeç dyshohet se ka kryer një krim, ai duhet të merret në mbrojtje nga institucionet dhe profesionistët e përmendur edhe më lart. Çdo aktor që kujdeset për mbrojtjen e fëmijës duhet të **veprojë menjëherë**.

Mbrojtja e fëmijës përmblodh të gjithë punën që bëhet, për të parandaluar dhe për t'iu përgjigjur në mënyrë të menjëhershme dhunës dhe abuzimit ndaj fëmijëve. Punonjësi i mbrojtjes së fëmijëve ofron përkujdes për fëmijën dhe familjen e tij/saj. Ai/ajo bashkëpunon me çdo aktor nga shëndetësia, arsimit, policia, gjykata në çdo hap.

Menaxhimi i rastit

Menaxhimi i rastit për fëmijën nën moshën e përgjegjesisë penale, i cili ka hyrë në konflikt me ligjin, kalon në 6 HAPA:

1. Regjistrimi i rastit

Hapi i parë që bën Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës është hapja e dosjes për fëmijën në konflikt me ligjin. Në këtë dosje vendosen dokumentat e mbledhura gjatë menaxhimit të rastit.

2. Vlerësimi fillestar

Punonjësi i mbrojtjes së fëmijëve në vlerësimin e parë, identifikon rrezikun ndaj fëmijës bazuar në informacione të marrë, nevojat bazë si dhe shërbimet e nevojshme për fëmijën. Ai/ajo ka përgjegjësi për të marrë masat emergjente të mbrojtjes, nëse vlerësohet edhe largimin e fëmijës nga familja apo ambientet e rrezikshme për të.

3. Vlerësimi i plotë

Vlerësimi i plotë i situatës së fëmijës në konflikt me ligjin është një proces që kryhet nga strukturat e mbrojtjes së fëmijës në bashkëpunim me shumë aktorë kur fëmija ka nevojë për mbrojtje. Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës analizon nivelin e rrezikut, nevojat e fëmijës dhe familjes, pikat e forta, aftësitë dhe mundësitë e fëmijës dhe familjes si dhe masën e marrë nga gjykata.

4. Hartimi i Planit individual të mbrojtjes (PIM)

Pas vlerësimit të rastit, Punonjësi i mbrojtjes së fëmijëve bashkëpunon me

aktorë që ofrojnë shërbime të ndryshme si dhe organizatat duke i krijuar fëmijës mundësi dhe ndihmë konkrete. Plani përmban veprime, ndërhyrje dhe shërbime të nevojshme për të ulur nivelin e rrezikut. Nëse është e nevojshme edhe shërbime për prindërit. Ky plan ruhet në dosjen e fëmijës. Çdo informacion në dosje i shpjegohet fëmijës në një gjuhë që e kupton dhe diskutohet me familjen.

5. Zbatimi, ndjekja dhe monitorimi i PIM-it

Çdo person i përfshirë në Planin Individual të Mbrojtjes ka përgjegjësi në ndjekjen e PIM. Punonjësja e Mbrojtjes së Fëmijëve drejton, organizon dhe ndjek punën. Plani që hartohet nuk mbetet në letër. Ai ndiqet me kujdes hap pas hapi nga të gjithë aktorët.

6. Mbyllja e rastit

- Jashtë rrezikut dhe nuk ka shqetësime të tjera
- Fëmija ka mbushur moshën 18 vjeç
- Fëmija ka ndërruar jetë
- Fëmija ka ndryshuar vendbanim ose vendqëndrim dhe dosja e tij është transferuar

Ju duhet të dini se: Edhe pse një rast mbyllet nuk do të thotë se PMF apo aktorë të tjerë nuk duhet ta mbajnë fëmijën në mbikqyrje. Një fëmijë ka gjithmonë nevojë për ndihmë në mënyrë që rasti të mos përsëritet.

Le të kuptojmë në praktikë konceptet e mësipërme

Menaxhimi i rastit të Erit

Eri është një fëmijë që shpesh merr pjesë në vjedhje. Ai është 13 vjeç dhe rasti i tij menaxhohet nga Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës. PMF është përgjegjëse që nga identifikimi dhe deri tek mbyllja e rastit. Policia e ka përcjellë informacionin e rastit tek punonjësja në bashki. Ajo hapi një dosje për fëmijën. Gjithashtu ajo vlerësoi nivelin e rrezikut duke marrë në konsideratë informacionin e dhënë nga babai dhe polici.

Punonjësi i mbrojtjes së fëmijëve në bashkëpunim me punonjësin social pranë bashkisë bëri një **vlerësim të rastit**. Më pas hartoi **Planin individual të mbrojtjes** bashkë me Grupin e profesionistëve ku merrnin pjesë: oficeri i policisë, psikologu, mësuesi dhe punonjësi social i Njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit të rastit. Grupi i profesionistëve u mbledh dhe e aprovuan planin për ta ndjekur. Plani iu shpjegua Erit në një gjuhë të thjeshtë në prezencën e të atit. Në çdo veprim të planit u vlerësua interesi më i lartë i Erit dhe çfarë është më e mira për të. Babai i tij do të këshillohet për t'u kujdesuar sa më mirë për Erin duke i qëndruar sa më pranë në mënyrë që të mos përsërisë gabimet e mëparshme.

PMF-ja kujdeset vazhdimisht për Erin. Realizon vizita në familje, flet shpesh me fëmijën si dhe bashkëpunon me mësuesit e tij. Është shumë e rëndësishme që kujdesi ndaj Erit të jetë gjatë gjithë kohës. Edhe shokët e tij e përfshijnë në aktivitete.

Gjatë menaxhimit të rastit është shumë i rëndësishëm:

- Ripërfshirja e fëmijës në shkollë dhe ndjekja nga psikologu/ punonjësi social shkollor;
- Ndjekja e aktiviteteve sociale;
- Rindërtimi i marrëdhënies me babain;
- Trajnime për babain në mënyrë që të kujdeset sa më mire për fëmijën dhe seanca për forcimin e aftësive prindërore për babain.

Pjesëmarrja në procese gjyqësore

Punonjësi i mbrojtjes së fëmijës duhet të marrë pjesë në proceset gjyqësore ku merren masat e mbrojtjes ndaj fëmijës. Ai vlerëson interesin më të lartë të fëmijës. Ai ka detyrë të përgatisë **çdo dokument** që kërkohet nga gjykata.

Deklarata e fëmijës duhet të bëhet gjithmonë në prani të një psikologu dhe me pëlqimin e fëmijës mbi 10 vjeç.

Familja dhe roli i saj gjatë menaxhimit të rastit

Prindërit duhet të kujdesen vazhdimisht për edukimin e fëmijëve duke i mësuar me vlera, sjellje, qëndrime që lidhen me të ardhmen tuaj. Familja luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin fizik, emocional, social dhe edukativ.

Faktorët familjarë që ndikojnë në nivelet e sjelljes negative të të miturve

a) Marrëdhënia me prindërit

Dashuria, siguria dhe mbështetja janë thelbësore në një familje.

Këshillë: Është shumë e rëndësishme të zhvilloni marrëdhënie të shëndetshme me prindërit. Edhe nëse hasni vështirësi komunikoni me to, me një psikolog, punonjës social, mësues apo dikë tjetër që i besoni!

b) Marrëdhëniet abuzuese

Pjesa më e madhe e fëmijëve në konflikt me ligjin vijnë nga familje të dhunshme.

Këshillë: Nëse keni problema të tilla në familje apo njihni një bashkëmoshatarin/en tuaj, ju lutemi referojeni rastin tek Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijëve, psikologu apo dikush tjetër që mund t'ju ndihmojë.

c) Neglizhimi

Kur një prind nuk i mbështet fëmijët nga ana emocionale, nuk i kushton vëmendje dhe nuk përfshihet me fëmijët, i mituri ka shumë mundësi të përfshihet në sjellje kriminale.

Këshillë: Flisni me PMF pasi ai/a jo mund t'ju ndihmojë prindërit të zhvillojnë aftësitë prindërore dhe të zhvillojnë marrëdhënie të shëndetshme me fëmijët e tyre.

Faktorët mbrojtës

Faktorët mbrojtës janë ata faktorë që i ndihmojnë fëmijët në konflikt me ligjin dhe i largojnë ata nga sjellje jo të përshtatshme dhe kriminale. Këto faktorë i ndihmojnë fëmijët ta zgjidhin më lehtë situatën e tyre. Prindërimi pozitiv, kujdesi prindëror, dashuria, disiplinimi, marrëdhëniet pozitive familjare dhe komuniteti mbrojtës, social dhe përfshirës janë faktorë mbrojtës tek fëmijët.

Llojet e ndihmës ndaj familjes

Ndihma për prindërit

Në rast se një familje ka nevojë ajo duhet të ndihmohet. Prindërit mund të marrin pjesë në trajnime rreth disiplinimit të fëmijëve.

Ndihma me shërbime

Një familje mund të fuqizohet nëse merr shërbime shoqërore, shëndetësore, ligjore apo çdo lloj ndihme tjetër në bazë të nevojave.

NIVELET E RREZIKUT

Rrezik i menjëhershëm

Në momentin kur fëmija identifikohet nuk ka aftësi për t'u mbrojtur nëse lihet në ato kushte. Nëse fëmijës nuk i ofrohet ndihmë ai rrezikon të humbasë jetën, të dëmtohet rëndë, të abuzohet, apo trafikohet. Nëse shikoni fëmijë në një gjendje të tillë flisni me prindërit tuaj, PMF-në, punonjës in social apo me çdo person tjetër që mund ta ndihmojë. Ky fëmijë ka nevojë për ndërhyrje urgjente.

Rrezik i lartë

Nëse një fëmijë ka mundësi të dëmtohet rëndë apo mund të ketë rrezik abuzimi të vazhdueshëm, kur rrezikon të mbetet i paaftë apo i rrezikohet jeta, ai duhet të mbrohet menjëherë.

Rreziku i mesëm

Nëse një fëmijë ndodhet në një situatë ku ka mundësi të dëmtohet apo të abuzohet nevojitet ndërhyrja për ta mbrojtur dhe për t'i ofruar shërbimet e duhura.

Rreziku i ulët

Ku fëmija gjendet në situata që është pak a shumë i sigurt, i aftë për të mbrojtur veten ai është në nivel të ulët rreziku.

Si të vlerësoni një fëmijë në nevojë për ndihmë?

Vëzhgoni nëse ambienti ku jeton është i përshtatshëm.


Vlerësoni sjelljen e tij/saj si dhe marrëdhëniet me të tjerët.

Vëzhgoni marrëdhënien me prindërit.

Shikoni nëse bullizohet dhe si është gjendja e tij emocionale.

Këshillë!

Nëse shihni që bashkëmoshatar i juaj jeton në kushte të tilla, sjellja e tij ka ndryshuar dhe marrëdhënia me prindërit nuk është pozitive ju lutem flisni me dikë të besuar që mund ta ndihmojë.



Sistemi i Mbrojtjes së Fëmijëve - Parimet dhe Standartet

Ju duhet të dini se: Kushtetuta e Shqipërisë parashikon të drejtën e fëmijëve për të pasur mbrojtje të veçantë nga shteti.

Parimet janë rregulla ligjore që theksojnë qëllimin e ligjit, duke treguar dhe mënyrën se si zbatohen rregullat ligjore më të detajuara dhe konkrete.

Vini re! Janë 11 parime thelbësore që zbatohen veçanërisht për të miturit në konflikt me ligjin.

Universaliteti i të drejtave Të drejtat tuaja janë universale. Ato ju përkasin vetëm ju dhe do ju shoqërojnë përgjatë gjithë kohës që jeni fëmijë. Shteti dhe kushdo ka detyrimin t'i përmirësojë standardet e shërbimeve përkundrejt këtyre të drejtave që JU gëzoni. Çdo person dhe institucion është i detyruar të zbatojë parimet e drejtësisë penale për të mitur, në çdo hap dhe në çdo vendim që merr lidhur me të miturin.!!!!

Prezumimi i pafajësisë - Çdo i mitur në konflikt me ligjin mendohet si i pafajshëm, derisa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor. Gjithashtu zbatimi i këtij parimi përfshin edhe të drejtën e heshtjes së fëmijës.

Interesi më i lartë i fëmijës Në çdo vendim vlerësohen si parësore nevojat e fëmijës, mendimet e tij/saj, historia e fëmijës, aftësitë prindërore si dhe marrëdhëniet me të tjerët.

Dinjiteti Personaliteti juaj, dinjiteti, nderi, gjuha, kultura dhe besimi fetar duhet të respektohen.

Ndalimi i diskriminimit Fëmijës në konflikt me ligjin i garantohen të drejtat pa asnjë lloj diskriminimi. Çdo fëmijë meriton të njëjtin nivel respekti.

Decentralizimi i shërbimeve Shërbimet që ofrohen për fëmijët në sistemin e mbrojtjes së tyre, ofrohen sa më pranë fëmijës.

Shërbimi i personalizuar Shërbimet ndaj fëmijës ofrohen në bazë të zhvillimit të fëmijës. Çdo fëmijë duhet të marrë mbështetjen dhe ndërhyrjen e duhur, sipas nevojave të tij të veçanta.

Qëndrueshmëria dhe vazhdimësia Kujdesi ndaj jush duhet të jetë i vazhdueshëm nga prindërit dhe profesionistët duke siguruar qëndrueshmëri. Ky trajtim me kujdes gjatë gjithë kohës ndikon drejtpërdrejt në rritjen dhe edukimin tuaj.

Përgjegjësia e prindit/kujdestarit vjen e para Kur fëmija në konflikt me ligjin e ka mbushur moshën e përgjegjësisë penale dhe duhet të përfshihet në procese gjyqësore, prindërit/kujdestarët ligjorë duhet të jenë pranë tij për ta mbështetur.

Ndarja e përgjegjësive Sistemi i mbrojtjes së fëmijëve përbëhet nga një grup aktorësh dhe organizatash që punojnë së bashku duke ndarë përgjegjësitë sipas detyrave që u takon. Të gjithë ofrojnë ndihmën dhe duken si ajo loja me puzzle (formuese) duke krijuar sistemin e mbrojtjes së fëmijës.

E drejta për zhvillim në harmoni Në çdo vendim dhe procedurë lidhur me drejtësinë penale për të mitur mbahet parasysh si shumë e rëndësishme e drejta e të miturit për zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror.

Parimi i ndërsjelltë Çdo masë e marrë ndaj të miturit në konflikt me ligjin i cili ka mbushur moshën e përgjegjësisë penale, duhet të merret duke vlerësuar rethanat e kryerjes së veprës penale si dhe kushtet personale, familjare dhe sociale.

Jetesa dhe rritja në mjedis familjar Çdo fëmijë duhet të jetojë e të rritet në një mjedis të përshtatshëm familjar duke e mbrojtur atë. Familja ose kujdestarët ligjorë të fëmijës duhet të kujdesen për zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijës.

Masat alternative vlerësohen të parat Kur duhet të merren masa ndaj të miturve, masat alternative vlerësohen të jepen të parat duke synuar rishoqërimin e të miturit dhe rehabilitimit e tij/saj.


Kufizimi i lirisë si masë e fundit Arrestimi, ndalimi ose burgimi i një të mituri nuk zbatohet nëse organet vlerësojnë se i mituri mund të marrë një masë më të butë.

E drejta e pjesëmarrjes Një prej parimeve më të rëndësishme në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve është pjesëmarrja, dëgjimi dhe respektimi i mendimit të fëmijës bazuar në moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar.

Shqyrtimi pa vonesë dhe me përparësi Kur i mituri në konflikt me ligjin i nënshtrohet procesit penal, të gjitha vendimet dhe veprimet e ndërmarra, që nga fillimi deri në fund të procesit penal vlerësohen me përparësi.

Pjesëmarrja e detyrueshme e psikologut Prania e psikologut është e detyrueshme dhe nevojshme në çdo fazë të procesit ku merr pjesë fëmija/i mituri. Ai/ajo e lehtëson të miturin në dhënien e dëshmisë, duke e ndihmuar nga ana emocionale gjatë procesit.

Të dhënat personale Informacionet në lidhje me të miturit janë shumë më personale dhe delikate dhe duhen ruajtur me shumë kujdes dhe në asnjë mënyrë nuk duhet të bëhen publike.



Pse është e rëndësishme pjesëmarrja e fëmijës?

Koncepti i Pjesëmarrjes

Pjesëmarrja është e drejta që përfshin të drejtën për t'u dëgjuar, të drejtën për t'u shprehur, të drejtën për të marrë pjesë pa u detyruar në proces si dhe aspektin që kjo e drejtë të jetë në përshtatje me moshën dhe aftësitë e fëmijës për të kuptuar.

Roli i pjesëmarrjes për një qasje të bazuar në të drejtat e fëmijëve

Një kuriozitet për ju fëmijë, nëse ende nuk e dini!!! Fjala pjesëmarrje do të thotë "të jesh pjesë e diçkaje". Ajo përfshin shkëmbimin e informacionit mes fëmijëve dhe të rriturve, të bazuar në respektin e ndërsjellë. Mos harroni që ju jeni zotëruar dhe "profesionisti" kryesor i të drejtave tuaja me rolin e identifikimit të nevojave tuaja.

Pjesëmarrja në sistemin e drejtësisë penale për të mitur

Pjesëmarrja i bën fëmijët protagonistë të jetës së tyre, madje edhe kur flasim për mungesën e lirisë. Ajo ju ndihmon që të ndjeheni të dëgjuar, të vlerësoni më shumë veprimet që kryeni, të bashkëpunoni për planin që keni hartuar bashkë.

Kush janë aktorët në këtë proces?

Këta aktorë mund të jenë: gjyqtarë, avokatë, oficerë policie, punonjës socialë, mësuesit dhe familjarët e fëmijës. Në një nivel më të gjerë, edhe hartuesit e politikave dhe shoqëria civile luajnë një rol të rëndësishëm në pjesëmarrje, duke përfshirë dhe median.

Rehabilitimi

Nëpërmjet pjesëmarrjes ju fëmijë nxiteni të braktisni vullnetarisht veprimet e shkeljes së ligjit dhe të (ri) krijoni lidhje pozitive dhe marrëdhënie mes jush dhe shoqërisë.

Rehabilitimi dhe përfshirja sociale është krijimi i mundësive dhe nxitjes së fëmijëve dhe të rinjve për t'u bërë anëtarë aktivë të komunitetit, të kontribuojnë me burimet dhe aftësitë e tyre, gjithashtu edhe të marrin një rol pozitiv në shoqëri.

Përvojat negative të fëmijërisë

Çfarë janë përvojat negative të fëmijërisë?

Ato janë disa situata që i keni kaluar ose po ju ndodhin tani, por mund të kenë efekte afatgjata negative në shëndetin dhe mirëqenien tuaj.

Gjithashtu përvojat negative të fëmijërisë mund të jenë edhe ato situata që vijnë nga përballja e vazhdueshme me stresin dhe mungesa e mbështetjes nga personat e rritur. Ato mund të çojë në pengesa në zhvillimit tuaj. Një fëmijë që është i stresuar dhe dhunuar mund të ketë prirje për të reaguar me dhunë, mund të ketë vonesa në zhvillim, kthim prapa, problem me veten, marrëdhënie të vështira shoqërizmi në shtëpi e jashtë saj, si dhe problem në të nxënë.

Lidhja me sjelljen e kundërligjshme

Faktorët që ndikojnë në shfaqjen e sjelljeve që shkelin ligjin janë prindërimi i vetëm, vështirësitë ekonomike, komunitet apo lagjja e varfër, abuzimi fizik dhe emocional.

Në përgjigje të ngjarjeve traumatike, fëmijët mund të shfaqin sjellje të rrezikshme si:

- Veprime që kanë ndikim afatgjatë jo pozitiv në shëndetin e tyre
- Probleme të rënda disiplinore në shkollë ose edhe përballje me dyert e sistemit të drejtësisë
- Të sillen me mospërfillje, armiqësi; të provokojnë apo të kryejnë agresione, duke i konsideruar si reagime vetëmbrojtëse.
- Përfshirja në rrezik
- Shkelja e rregullave
- Dëmtimi i tjetrit që perceptohet si i fuqishëm etj.

Këto mund të bëhen mënyra apo mjete mbijetese dhe pikërisht sjellje të tilla i sjellin të miturit në sistemin e drejtësisë.



Provoni Vetën Tuaj!!

QARKO përgjigjen e saktë:

Menaxhimi i rastit të fëmijës në moshë për përgjegjësi penale

Arbri është një djalë 16 vjeç, fëmijë i dy prindërve të divorcuar për shkak të dhunës në familje. Familja e tij ka edhe probleme ekonomike. Pak ditë pasi kishte mbushur 16 vjeç, gjatë një konflikti të çastit, ai goditi me thikë një nxënës në shkollë. Një polic që u ndodh aty pranë, e arrestoi menjëherë për plagosje të rëndë me dashje ndaj shokut të shkollës.

Si do ta ndihmonit ju Arbrin? Rendisni sipas rradhës 3 hapat më poshtë që ju mendoni se do të ndiqen për Arbrin, përmes sistemit të drejtësisë penale për të mitur.

- () gjykimin dhe dënimin;
- () hetimet paraprake;
- () ekzekutimin e masës/të dënimit penal.

LIDH

Hetimi dhe gjykimi penal

Ju lutem **lidhni hapin** në kolonën e parë **me profesionistët** që e kryejnë atë në kolonën e dytë.

Hapat

- Identifikimi i fëmijës së përfshirë •
- Vlerësimi fillestar i situatës •
- Plani individual i mbrojtjes •
- Vendosja e masës •
- Ndjekja e hetimeve •

Profesionistët Përgjegjës

- PMF-ja
- Punonjësi i policisë
- GTN
- Policia Gjyqësore
- Prokurori

QARKO përgjigjen e saktë:

Masat detyruese ndaj fëmijës/të miturit mund të jenë:

- a) T'i ndalohen fëmijës/të miturit veprime
- b) Të nxitet shkëputja e tij nga ndikimet negative
- c) Të sigurohet mbështetja dhe mbikëqyrja e nevojshme
- d) Të synohet përfshirja e fëmijës në arsim, punësim të përshtatshëm për moshën, programe edukative përmirësuese dhe/ose mjekësore

QARKO nëse pohimi më poshtë është i vërtetë apo i gabuar:

- V G** Masa e dënimit me burg vlerësohet si masa e fundit që duhet marrë ndaj një fëmije/të mituri
- V G** Familja luan një rol shumë të rëndësishëm në përmirësimin e sjelljes së fëmijës/të miturit dhe të integritetit të tij në shoqëri pas përfundimit të dënimit.
- V G** Një vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet seancave këshilluese individuale lidhur me orientimin profesional të të miturit.

QARKO alternativën e saktë!

E drejta e pjesëmarrjes - Neni 12 i Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve i përket:

- a) të drejtës së lojës
- b) të drejtës për t'u shprehur
- c) të drejtës për t'u dëgjuar

QARKO më shumë se një përgjigje që ju vlerësoni si të saktë:

E drejta për t'i shprehur pikëpamjet lirisht - Neni 12 Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve, i njeh fëmijët si mbajtës të të drejtave, për t'u dëgjuar dhe marrë parasysh mendimet. E drejta e shprehjes është:

- a) Vullnetare
- b) Detyrim
- c) Zgjedhje

QARKO më shumë se një alternativë që mendon se është e saktë:

Dhënia peshë e mendimeve të fëmijës - Neni 12 i Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve shprehet se fëmijët duhet të dëgohen në procese gjyqësore dhe duhet të jenë të informuar para se të japin mendimin e tyre. Kur te rriturit marrin vendime për fëmijët duhet të:

- a) Të kuptojnë e interpretojnë nevojat
- b) Të mos dëgjojnë mendimet e fëmijëve
- c) Të marrin parasysh mendimet e fëmijëve
- d) Të sigurojnë që fëmijët ose përfaqësuesit të kontrollojnë burimet e informacionit

QARKO për çdo fjali nëse është e vërtetë ose e gabuar

Në përputhje me moshën dhe pjekurinë e fëmijës

- V G** Mendimi i shprehur nga një fëmijë më i madh meriton më tepër vëmendje sesa ai i një fëmije më të vogël.
- V G** Jo fëmijët, por profesionistët duhet të vlerësojnë aftësinë e fëmijës për të formuar një mendim mbi situatën, pavarësisht nga mosha dhe zhvillimi.


QARKO nëse pohimet më poshtë janë të vërteta ose të gabuara:

- V G** **Pjesëmarrja në sistemin e drejtësisë penale për të mitur**
Pjesëmarrja i ndihmon fëmijët të marrin rolin e personazhit kryesor në rikthimin e tyre në gjendjen e mëparshme dhe përfshirjen sociale.
- V G** **Pranimi**
Procesi i njohjes/pranimit dhe i respektit është i ndërsjellë, ndihmon që shoqëria apo komuniteti ta pranojnë fëmijën në konflikt me ligjin.
- V G** **Përgjegjësia**
Ju duhet të jeni pjesë e planit që ndërtohet për rikthimin tuaj në gjendjen e mëparshme.

QARKO nëse është e vërtetë ose e gabuar

Lidhja me sjelljen e kundërligjshme

- V G** Çdo fëmijë i cili përjeton një ngjarje të dhunshme dhe traumatike, do të përfshihet në sjellje të kundërligjshme dhe do të shkelë ligjin.



Ky publikim është përgatitur në kuadër të projektit “Fuqizimi i Sistemit të Mbrojtjes së Fëmijëve në Konflikt me Ligjin” i cili është zbatuar nga Misioni Terre des hommes në Shqipëri në partneritet me Defense for Children International the Netherlands (DFC-NL).

Ky publikim është mundësuar me mbështetjen financiare të programit MATRA Holandë. Përmbajtja është përgjegjësi e Misionit Terre des hommes në Shqipëri dhe nuk reflekton domosdoshmërisht opinionin e programit MATRA.